



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 15, datë 20.06.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË,**  
**HIDROCENTRALIT “RAZDOLL”, NË PËRROIN E RAZDOLLIT, DEGË E**  
**LUMIT OSUM, BASHKIA KOLONJË, QARKU KORÇË”**


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Hidro Vizion” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Razdoll”, në përroin e Razdollit, degë e lumit Osum, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hidro Vizion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Kolonjë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

